



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

Nr. prot _____, _____, 2023

**NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORË TË JASHTËM PËR ZHVILLIMIN E
PROCEDURAVE NË KUADËR TË TESTIMIT TË INFORMATIZUAR
“MËSUES PËR SHQIPËRINË”, VITI 2023**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm, hartues të fondit të pyetjeve, në kuadër të testimit të informatizuar ‘Mësues për Shqipërinë’, viti 2023.

Bashkëpunëtorët e jashtëm për hartimin e fondit të pyetjeve në kuadër të testimit të informatizuar ‘Mësues për Shqipërinë’, viti 2023 duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë në ciklin/profilin përkatës.
2. Të kenë përvojë mbi 5 vjet si mësues në arsimin e mesëm parauniversitar ose arsimin e lartë.
3. Të kenë përvojë mbi 5 vjet në mësimdhënie në ciklin/profilin përkatës.
4. Të kenë vlerësimin shumë mirë ose shkëlqyeshëm në provimin e kualifikimit (nëse e kanë dhënë një të tillë).
5. Të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillimin e tyre profesional.
6. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
7. Të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj.
8. Të përdorë kompjuterin.

Kandidatët për hartues të fondit të pyetjeve dorëzojnë CV-në dhe dokumentacionin përkatës pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), brenda datës 08.02.2023, ora 16.00.

Faleminderit!